



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A – Prishtinë, Ad: " Luan Haradinaj", p.n.

Tel: 038/249-424, Fax: ++381(0)38/ 249-430.

e-mail.: contact@pallatirinise.com

Në bazë të vendimit të Menaxhmentit, Ndërmarrja Publike Lokale PALLATI I RINISË SH.A., **shpallë:**

FTESË PËR OFERTË PËR DHËNIEN ME QIRA TË HAPËSIRAVE AFARISTE

Ftoheni që të ofertoni për marrje në shfrytëzim me qira të lokalet afariste, zyre dhe depot të cilat janë pronë e N.P.L PALLATI I RINISË SH.A. Pronat e evidentuara me poshtë u jepen me qira personave juridik.

Hapësirat afariste të cilat jepen me qira:

Nr.	Adresa	Sipërfaqja	Çmimi fillestar për m ² (pa TVSH)
1.	Depo nr. 02	54 m ²	6.17€
2.	Depo nr. 05	60 m ²	6.17€
3.	Depo nr. 08	60 m ²	6.17€
4.	Zyre nr. 116	39 m ²	5.00€
5.	Zyre nr. 130	288 m ²	5.00 €

Kushtet e Përgjithshme

1. Periudha e qiradhënies është për 1 (një) vit, me mundësi vazhdimi.
2. Qiramarrësi me anë të nënshkrimit të kontratës me qiradhënësin, është i obliguar që të bëjë parapagimin e një shumë monetare në vlerë të një qiraje mujore në llogari të Qiradhënësit.
3. Qiramarrësi është i obliguar që pas nënshkrimit të kontratës të bëjë sigurimin e mallit nga kompanitë e sigurimit.
4. Përveç çmimit fillestar, qiramarrësi do të paguaj plus shpenzimet tjera të parashikuara me kontratë (rrymë, pastrim, nxehe, ujë, kanalizim).
5. Këto lokale nuk janë të destinuara për hotelieri.

Kriter për përzgjedhjen e ofertuesit me të favorshëm është:

1. Çmimi me i lartë i ofertuar se sa çmimi fillestar.
2. Marrja me qira e krejt lokaleve.
3. Tarifa e aplikimit është 200.00 €, ku ofertuesit të zgjedhur, tarifa e aplikimit do ti kompensohet me faturën e parë të qirasë, ndërsa ofertuesit të zgjedhur i cili tërhiqet nga Kontrata për qira, nuk i kthehet tarifa e aplikimit prej 200.00 € dhe ofertuesit të pazgjedhur i kthehet tarifa e aplikimit prej 200.00 €, e cila do të paguhet në këtë Kont: **1708020600000056**.

Ofertuesi duhet t'i dorëzoi këto dokumente:

1. Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit dhe numrit fiskal (kopje)
2. Kopjen e një dokumenti identifikues të pronarit ose të përfaqësuesit të biznesit; (kopje)
3. Çmimin e ofertuar për m² i cili duhet të jetë pa TVSH (Ofertë)
4. Vërtetimin nga ATK-ja, qe të dëshmohet se biznesi është aktiv;
5. Fletëpagesën për aplikim.

Ofertat nuk do të merren parasysh nëse:

1. Ofertuesi i cili ka pasur lokal me qira në Pallatin e Rinisë dhe nuk i është përmbajtur kontratës së qirasë ose ka obligime ndaj Ndërmarrjes;
2. Nëse oferta nuk i përmban të gjitha dokumentet e kërkuara;
3. Nëse Oferta arrin pas datës së skadimit të afatit të dorëzimit të ofertave të përcaktuar në shpallje.

Personat juridik të cilët duan t'i vizitojnë lokalet, zyrat si dhe depot e lartcekura, mund t'a bëjnë, nga data: **06.10.2021**, deri me datën: **10.10.2021** nga ora **10⁰⁰** deri në ora **15⁰⁰**.

Ofertat duhet të dorëzohen në zarf të mbyllur me datën: **11.10.2021** nga ora **10⁰⁰** deri në orën **12⁰⁰**, në zyrën e arhivës së qiradhënësit N.P.L PALLATI I RINISË SH.A. Në pjesën e jashtme të zarfit duhet të specifikohet: emri i ofertuesit, nr i lokalit, zyrës ose depos dhe kontaktet, si: email-i zyrtar, dhe/apo nr. i telefonit.

Ofertat do të hapen nga ana e komisionit, me datë: **11.10.2021** nga ora: **12:30** në prezencën e ofertuesve, në zyrën e Drejtorisë së Pallatit të Rinisë në Prishtinë. Kërkesa (aplikacioni) mund të kërkohet përmes email-it: contact@pallatirinise.com dhe në formë fizike në zyrën nr. 17, apo të shkarkohet nga faqja zyrtare e "Pallatit të Rinisë": <http://www.pallatirinise.com>.